



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 486 prot.

Tiranë, më 06 . 04 . 2023

V E N D I M

Nr. 53, datë 06 . 04 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën me nr. 182 Regj., datë 21.11.2022, paraqitur nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Durrës-Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, përfaqësuesi i kësaj Shoqate, S. F, parashtron se:

“Unë presidenti i Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, S. Fi, me datë 17.11.2022 kam udhëtuar me autobusin e linjës Tiranë-Durrës, me targën AA 230 NJ, së bashku me shoqëruesen time, në orën 09:00 të mëngjesit. Në momentin që faturino mbledh lekët unë i kam paraqitur librezën e verbërisë dhe pagesën që na takonte (si mua, ashtu dhe shoqërueses time) gjysëm biletë për secilin. Faturinoja nuk pranoi pasi kërkoi të bënim pagesë të plotë, gjë të cilën u detyruam ta kryenim. Ky veprim diskriminues është bërë në vazhdimësi dhe në mënyrë të përsëritur nga kjo linjë kundrejt personave që kanë librezën e të verbërit, duke i detyruar ata të paguajnë biletë të plotë, kur në fakt ligjërisht na takon të paguajmë gjysëm bilete në udhëtimet në mjetet e transportit ndërqytetës. Kërkojmë ndalimin e diskriminimit nga kjo linjë dhe njohjen nga ana e saj të së drejtës tonë ligjore, që të verbërit që janë të paisur

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

me librezë verbërie të udhëtojnë me mjetet e transportit ndërqytetës, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit””.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga linja e transportit Tiranë-Durrës dhe anasjelltas, për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe rregullimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tyre nga kjo linjë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a) dhe shkronja b), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, si dhe të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet*

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën LMD.

ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Pala ankuese, pretendon se është diskriminuar si person fizik, lidhur me ngjarjen e datës 17.11.2022, por gjithashtu, në tagrin e përfaqësuesit të Shoqatës, ka pretenduar diskriminim të gjithë kategorisë së personave të verbër (njohur sit ë tillë nëpërmjet vërtetimit të KMCAPI, nga ana e Shoqërisë, e cila nuk pranon t’u njohë të drejtën e udhëtimit me biletë me gjysëm çmimi, përmes paraqitjes së fotokopjes së Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose të Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Bazuar në LMD, pala ankuese: edhe si person fizik, edhe si përfaqësues i Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri gjykon se, në adresimin e kësaj problematike kanë interes legjitim të gjitha organizatat apo subjektet përfaqësuese të personave më aftësi të kufizuara në shikim, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të

aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”

Bazuar në nenin 32/1/a/b, të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në kushtet që, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë-Durrës dhe anasjelltas, me të cilën kishin udhëtuar në datën 17.11.2022, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 1510/1 prot., datë 24.11.2022, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
 - Me shkresën nr. 25989/1 prot datë 07.12.2022³, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se:

“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhërit Nr.318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave për operimin në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus. Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Durrës-Tiranë, operon subjekti “ELALBA-1” sh.p.k, me NIPT K12202003J, mbajtësi i licencës me nr.9, lëshuar në datën 12.05.2022. me afat vlefshmërie deri në datën 11.05.2027

Mjeti me targë AA 230 NJ është në pronësi të shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k. dhe është i certifikuar për operimin në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Durrës-Tiranë, për shoqërinë “ELALBA-1 sh.p.k, mbajtës i certifikatës me nr. 18, datë 12.05.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 12.05.2023”.

2. Pas marrjes dijeni nga ana e DPSHTRR, lidhur me subjektin privat, shoqërinë “ELALBA-1” sh.p.k, i cili kishte në pronësi mjetin me targë AA 230 NJ; nëpërmjet

³ Protokolluar pranë KMD-së me datë 12.12.2022.

shkresës me nr. 1510/3 prot., datë 15.12.2022 njoftoi subjektin lidhur me pretendimet e subjektit ankues dhe kërkoi informacionin e nevojshëm.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 07 prot., datë 21.12.2022, Shoqëria ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj përsa i takon pretendimeve të paraqitura nga subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se:

“...ne vazhdimisht kemi udhëtarë që përfitojnë nga statusi i tyre si: të verbër, invalidë, veteran luftime, etj, por që tregohen korrekt duke paraqitur dokumentin origjinal sipas kërkesave të ligjit dhe nga ana jonë u merret pagesa për gjysmën e çmimit të biletës.

Rasti i datës 17.11.2022 është ndryshe, pasi personi ankues, S. F nuk ka paraqitur para punonjësit dokumenta të rregullta, por vetëm fotokopje të pa dallueshme, me mangësi. Kjo ka qenë arsyeja që i është kërkuar të bëjë pagesën e plotë.

Këtë rast e analizuar si masë parandaluese që të mos kemi konflikt me pasagjerët me status, dhe do të angazhojmë menaxherët e linjës që, në raste nëse do ketë problematika të tilla, ata të vihen në dijeni dhe në stacionin fundor të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për palët.

Edhe në të ardhmen jemi të angazhuar të zbatojmë plotësisht kërkesat e ligjeve që kanë të bëjnë me individët me statusin e të verbërit, para e tetraplegjikut, etj”.

3. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 289 prot., datë 20.02.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore,
4. Nëpërmjet e-mailit të datës 02.03.2023, Shoqëria, ka njoftuar Komisionerin se për arsye objektive nuk mund të paraqiten në seancë në datën 06.03.2023.
5. Në këto kushte Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës në datën 23.03.2023, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

Seanca u zhvillua me praninë e të dyja palëve: subjektin ankues, S. F personalisht, i cili gëzon edhe cilësinë e presidentit të Shoqatës, si dhe N. D, Administratorit të shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k.

Lidhur me çështjen objekt ankese, palët gjatë seancës mbajtën të njëjtin qëndrim si ai i paraqitur shkresësisht para Komisionerit.

Së pari, subjekti ankues, ka pretenduar se është diskriminuar personalisht, si person me aftësi të kufizuar/status të verbëri.

Lidhur me situatën personale të tij, ai u shpreh se, me datë 17.11.2022, në autobusin e linjës Tiranë-Durrës, me targë AA 230 NJ, është detyruar të paguajë me çmim të plotë biletën e

udhëtimit, nga faturinoja i autobusit që është në pronësi të shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k. Ai u shpreh se ka paraqitur para faturinos fotokopjen e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, si dhe Librezën e Verbërisë (origjinalen) lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, president i së cilës është vetë ai. Ankuesi shprehet se fotokopja është dokument ligjor dhe ai mban fotokopje nga frika se dokumenti origjinal mund t’i humbasë dhe se noterizimi i saj ka kosto financiare. (Ky pretendim shtrihet edhe në kuadër të pretendimit të diskriminimit të anëtarëve të tjerë të Shoqatës, të cilët ai përfaqëson).

Së dyti, subjekti ankues në cilësinë e presidentit të Shoqatës ka pretenduar diskriminim të gjithë personave me AK, persona të verbër, vërtetuar me anë të raportit mjeko-ligjor të KMCAP, lidhur me faktin që kjo Shoqëri nuk u njeh të drejtën e udhëtimit me biletë me gjysëm çmimi, përmes paraqitjes së fotokopjes së Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Administratori i Shoqërisë, gjatë parashtrimeve të tij pranoi faktin që debati mes z. F dhe faturinos së autobusit që ata posedojnë, ka ndodhur, dhe që atij i është kërkuar të bëhet pagesa e plotë e biletës, por vetëm për faktin që ai nuk ka paraqitur dokumentacionin e duhur në formën e kërkuar nga ligji. Ai u shpreh se, Shoqëria e tyre, nuk njeh si të ligjshëm asnjë dokument i cili paraqitet në formën e fotokopjes së panoterizuar, pasi nuk provohet ligjshmëria e autenciteti i tyre. Ata njohin si dokument të ligjshëm vetëm Librezën e Verbërisë (origjinale ose fotokopje të noterizuar) lëshuar nga autoriteti i Shërbimit Social Shtetëror dhe jo atë të lëshuar nga Shoqata, president i së cilës është z. F, pasi librezat e lëshuara prej saj nuk janë në formën e kërkuar nga ligji.

Përfaqësuesi i Shoqërisë u shpreh se, të gjithë personave me aftësi të kufizuar, e çfarëdolloji qoftë ajo, u njihet e drejta e udhëtimit me autobusët e tyre, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, me kushtin e vetëm që ata të paraqesin dokumente provuese, në formën e kërkuar nga ligji.

Gjithashtu shtoi se, problematika të tilla kemi hasur vetëm nga ankuesi dhe bashkëshortja e tij, të cilët kanë këmbëngulur që faturinoja të njohë si dokument të vlefshëm për përfitimin e udhëtimit me biletë me gjysëm çmimi, fotokopjen e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga ISSH ose Librezën e Verbërisë, të lëshuar nga Shoqata të cilën drejton vetë ankuesi.

Në përfundim të seancës, subjekti ankues kërkoi që atij si person por edhe të gjithë personave me aftësi të kufizuar, të verbër, Shoqëria “ELALBA-1” sh.p.k t’u njohë të drejtën e udhëtimit me biletë me gjysëm çmimi, përmes paraqitjes së fotokopjes së Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm të ankuesit nga ana e Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Në ankesën e depozituar nga ana e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, pretendohet diskriminimi i shtetasit S. F dhe i gjithë personave me aftësi të kufizuara, (me status të verbëri), nga ana Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës së kësaj kategorie personash për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas, me biletë me gjysëm çmimi.

Pretendimet e subjektit ankues (për vetë atë si person, si dhe për gjithë kategorinë e personave të verbër, të cilët përfaqëson në tagrin e presidentit të Shoqatës) lidhen me dy kërkesa specifike kundrejt kësaj Shoqërie:

- T’u njihet e drejta e udhëtimit në linjën ndërqytetase me biletë me gjysëm çmimi, duke paraqitur fotokopjen e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga SHSSH.
- Ose, t’u njihet e drejta e udhëtimit në linjën ndërqytetase me biletë me gjysëm çmimi, duke paraqitur Librezën e Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Lidhur me këto dy momente, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban ndërqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër (njohur me dokumentin mjeko-ligjor të KMCAp-së), me biletë me gjysëm çmimi.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi⁴ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas⁵ dhe (3) transport ndërqytetas⁶.

Transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qëndror dhe atë vendor.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizë Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë

⁴ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

⁵ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

⁶ Transporti ndërqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: *“Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.”*.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”*. Aktualisht, ky nen parashikon: *“Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban falas dhe transport interurban⁷/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së⁸ lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit”*, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.

Komisioneri, vëren se, pavarësisht këtij vakumi ligjor, Kompania njuh dhe zbaton detyrimin e saj, përcaktuar edhe në aktet e tjera rregullatore që lidhen specifikisht me të drejtën e ushtrimit të shërbimeve që ofron kjo Kompani, si dhe Licencën për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetase të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.

Detyrim ky i konfirmuar në përgjigjen zyrtare depozituar pranë KMD-së, si dhe në qëndrimin e deklaratimit gjatë seancës të përfaqësuesit të Kompanisë.

⁷ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁸ Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

Nga ana tjetër, ankuesi nuk kishte kontestime lidhur me faktin që shërbimi nuk ofrohej konform lehtësirave të parashikuara për personat me status të verbëri nga ana e Kompanisë, por kontestoi vetëm faktin që atyre duhej t'u njihej si dokument i vlefshëm udhëtimi fotokopja e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga SHSSH ose Libreza e Verbërisë, lëshuar nga Shoqata që ankuesi përfaqëson, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban ndërqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, “*Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve*”, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë.

Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar)⁹ parashikon se:

⁹ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*).

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jasthtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjies për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të vecanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njuh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar se cilat shkresa konsiderohen *dokumet ligjor*, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

.....

10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër behet me 0% te tarifave për transportin urban dhe 50% te tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i te verbërit të grupit të parë”.

Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun VIII “Shkresat” ka përcaktuar respektivisht si më poshtë citohet:

Neni 246 “Fuqia provuese e shkresave” ka parashikuar se:

“Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

Neni 251 “Kopja e shkresës dhe origjinale i saj”, i tij, ka parashikuar se:

“Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin”.

Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, në nenin 3/c) të tij, ka përcaktuar se:

““Noter” është personi fizik i licencuar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale brenda territorit të një bashkie të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Në Kreun V të këtij ligji, janë përcaktuar kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e noterit. Kështu, neni 62, pika 1/i, e tij ka parashikuar se:

“Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësime, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar:

.....
i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ligji ka mirëpërcaktuar se cilat shkresa konsiderohen si dokument ligjor, mënyrën e hartimit apo njësimit të tyre si dhe autoritetin përgjegjës i cili gëzon ligjërisht këto kompetenca. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i subjektit ankues që, fotokopja e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga ISSH, të njihet si dokument provues i ligjshëm; nuk qëndron pasi është i pabazuar ligjërisht. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson të drejtë kërkesën e Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k, lidhur me detyrimin e subjekteve që disponojnë Librezë Verbërie të SHSSH, për të paraqitur dokumentin origjinal, ose fotokopjen e noterizuar të saj, si dokument të vlefshëm sipas përcaktimeve specifike ligjore, në mënyrë që të përfitojnë nga lehtësirat përcaktëse për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas me biletë me gjysëm çmimi.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi dhe të gjithë personat në kushte të njëjta me të, nuk janë ekspozuar ndaj një qëndrimi të pabarabartë e pafavorshëm, nga ana e Shoqërisë.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e kësaj Shoqërie, ardhur për shkak të aftësisë së kufizuar.

- *Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të Shoqatës që anëtarëve të saj, t’u njihet e drejta e udhëtimit në linjën ndërqytetase me biletë me gjysëm çmimi, duke paraqitur Librezën e Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.*

Përfaqësuesi i Shoqatës, z. F, ka pretenduar se Shoqëria “ELALBA-1” sh.p.k diskriminon të gjithë personat e verbër të cilët janë të pajisur me dokumentin e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, pasi nuk e quan të ligjshëm këtë dokument, duke bërë diferencime krahasuar me nga dokumentin që lëshon Shoqata e Invalidëve të Punës, lidhur me invalidët e punës, dokument të cilin kjo Shoqëri deklaron se e njih dhe e merr në

konsideratë lidhur me lehtësirat në transportin interurban, që u bëhen personave me status invalid pune.

Lidhur me këtë pretendim të Shoqatës, Komisioneri gjykon se, këto dy kategori personash me aftësi të kufizuar: ato me status të verbëri dhe ato me status invalid pune, përfitojnë lehtësira lidhur me transportin urban, sipas parashikimeve ligjore përkatëse që rregullohen në ligjin specifik të secilës kategori.

Kështu, ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, në nenin 4, të tij ka përcaktuar se:

“Invalidët paisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAP”.

Pra, bazuar në ligjin sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës.

Ndërsa, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, lidhur me pretendimin e njohjes si dokument zyrtar të ligjshëm të Librezë së Verbërisë së lëshuar prej tyre, është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me Shoqatën e Invalidëve të Punës, do të duhej që fillimisht ata të ishin në kushte të njëjta me të.

Për rrjedhojë, në situatën e analizuar më sipër (parashikimet ligjore për legjitimimin e autoriteteve përgjegjëse kompetente për lëshimin e dokumentit zyrtar të identifikimit të paaftësisë) rezulton qartë që subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, nuk ndodhet në kushte të njëjta me Shoqatën e Invalidëve të Punës, dhe për rrjedhojë, nuk mund të krahasohet me të, dhe në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se nuk mund të pretendohet për trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm krahasimisht me të.

Në mungesë të këtij trajtimimi, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm me “krahasuesin”, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar. Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, shtetasit S. F dhe të anëtarëve¹⁰ të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, në fushën e të mira dhe shërbimeve, nga ana e Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: AK

¹⁰ Paisur me dokumentin Librezë Verbërie, lëshuar nga SHSSH.